

## Si ta regjistroj të drejtën pronësore që rrjedh nga vendimi i Gjykatës?

Kur gjykata ka vendosur për një mosmarrëveshje rreth të drejtave pronësore, gjykata mund ta nxjerrë një vendim me të cilin i përcakton të drejtat ligjore mbi pronën e paluajtshme. Personi, të drejtat pronësore të së cilit janë themeluar nga gjykata, duhet ta regjistrojë të drejtën e tij pronësore në Zyrën Kadastrale Komunale (ZKK).



## SI TA REGJISTROJ TË DREJTËN PRONËSORE QË RRJEDH NGA VENDIMI I GJYKATËS?



PHOTO: SAYIB KARIMOV

## Pse duhet ta regjistroj?

### **Siguria**


Regjistrimi i pronës ju jep sigurinë ligjore.

### **Liria më e madhe**

Kur të regjistrohet prona juaj, ju mund ta shitni më lehtë, mund ta ndani dhe mund t'ia leni fëmijëve tuaj.

### **Më shumë mundësi**

Kur të regjistrohet prona juaj, ju mund të bëni kërkesë për t'a lënë atë në hipotekë apo të bëni kërkesë për ndonjë subvencion qeveria.



## I. Regjistrimi i pronës në Zyrën Komunale Kadastrale (procesi zgjatë 1-3 ditë)

Në rrethanat kur një personi i është konfirmuar e drejta pronësore nga gjykata, ai person duhet t'i paraqesë dokumentet e mëposhtme pranë ZKK-së për regjistrimin e të drejtave të tij pronësore:

- Formularin e plotësuar të kërkesës,
- Vendimin zyrtar të gjykatës,
- Kopjen e letërnjoftimit të pronarit të ri,
- Kopjen e planit të pronës (që merret nga sektori i gjeodezisë në Zyrën Kadastrale Komunale me pagesë prej 5 €),
- Dëshminë e pagesës së tatimit në pronë (nga Zyra Komunale e Financave), dhe
- Paga e tarifës për regjistrim (50 €).

Koha e parashikuar për t'i mbledhur këto dokumente është 1-3 ditë.

## Nuk keni nevojë që të shkoni tek noteri.

Çdo pagesë e tarifës ose taksës mbi 10 € duhet të bëhet në bankë dhe kërkohet dëshmia e pagesës bankare. Të gjitha pagesat nën 10 € paguhen në zyrën përkatëse.

## II. ZKK-ja e kryen regjistrimin (procesi zgjatë 15 ditë)

ZKK-ja detyrohet me ligj që ta kryejë regjistrimin brenda pesëmbëdhjetë ditëve. Gjatë kësaj periudhe, njoftimi i transferimit të pronësisë postohet në tabelën e informatave të ZKK-së për pesë ditë. Pas miratimit të regjistrimit të ri, ZKK-ja e njofton pronarin e ri për të ardhur në ZKK për ta marrë kopjen e certifikatës së pronësisë.

Koha maksimale për ta kryer këtë proces vlerësohet të jetë 15 ditë.